

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-012 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA GLLOGOC

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-18-4347-5-1-1
Nr i brendshëm	611 - 18 -0 65 - 511

Sa i përket tenderit për

NDËRTIMI I STADIONIT TË QYTETIT – FAZA E DYTË (PROJËKT TRE VJEQAR)

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

BM Group Sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Veternik, Magj Prishtine-Ferizaj km2
(Adresa)

Prishtine
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

+383 49 437407
(Numri Telefonit)


N/A
(Numri i Faks-it)

Bedri Gllareva
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bedri.gllareva@bmgroup-rks.com; rinor.vitaku@bmgroup-rks.com
(Adresa elektronike)

10.09.2018
(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vulë)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës"; "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë si dhe Dosja e Tenderit janë publikuar me datën 18.06.2018 në faqen zyrtare e-prokurimi.rks-gov.net prej nga edhe i kemi shkarkuar Dosjen e Tenderit dhe Paramasën.

Me datën 30.07.2018 është publikuar "B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara"

Dorëzimi i dosjes nga kompania jonë është bërë me datën 31.07.2018 para orës 14:00. Procesi i hapjes së tenderit është bërë me datë 31.07.2018 nga ora 14:00.

Me datën 06.09.2018 AK ka publikuar "B 58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK" përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net, ku si fitues të propozuar për kontratë është shpallur konsorciumi NN 100% Design shpk & Termomontimi Shpk



Poashtu me këtë datë pra 06.09.2018, AK na ka dërguar "B46 BM- Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshem" ku si fitues të propozuar për kontratë është shpallur kompania NN 100% Design shpk & Termomontimi Shpk

Me datën 06.09.2018 kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e tenderuesit të propozuar për nënshkrim të kontratës. Me datën 07.09.2018 në ora 10.30 ë na u është lejuar qasja në dokumentacionin e tenderuesit të propozuar për nënshkrim të kontratës.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Procesi i hapjes së tenderëve ka shkuar normalisht, komisioni i përbërë prej 3 personave ka lexuar çmimet për të gjitha kompanitë pjesëmarrëse dhe nuk ka pasur ndonjë vërejtje në lidhje me ecurinë e hapjes.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtuljeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐


6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Amulim.

Ne mendojmë se AK ka bërë shkelje të Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 referuar si LPP

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet



Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me datën 06.09.2018 përmes e-prokurimi@rks-gov.net nga AK kemi pranuar B 58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK” si dhe përmes emailit po me këtë datë kemi pranuar “B46 BM- Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshem” në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, ku për këtë tender për nënshkrim të kontratës është propozuar konsorciumi i Operatorëve: NN 100% Design shpk & Termomontimi Shpk

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të konsorciumit të propozuar për nënshkrim të kontratës NN 100% Design shpk & Termomontimi Shpk kemi hasur në disa parregullsi dhe deklarojmë se ne si Operatorë Ekonomik, “BM Group” Sh.p.k, nuk pajtohemi me vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe mendojmë se AK duhet të shqyrtojë edhe një herë vendimin e tij për këto arsye :

- 1) Tek dosja e tenderit FTD Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 është kërkuar është kërkuar: pika 1 b) kërkohe

-Kërkesa

Udhëheqës i punishtës: Një inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë ose bachelor Drejtimi Konstruktiv me 5 vite përvojë pune pas diplomimit si dhe të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekt të ngjajshëm (rikonstruktiv, ndërtim apo renovim të stadioneve) në vlerë mbi 500,000.00 €.


-Dëshmia

Udhëheqësi i punishtës, inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose bachelor drejtimi konstruktiv me 5 vite përvojë pune pas diplomimit

Konsorciumi i propozuar për dhënie të kontratës si udhëheqës të punishtës e ka caktuar Mentor Vehbi Hamzen bachelor i ndërtimtarisë. Siç mund të vërehet në kërkesën nga dosja e tenderit nga udhëheqësi i punishtës është kërkuar që të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekt të ngjajshëm dhe specifikohet “(rikonstruktiv, ndërtim apo renovim të stadioneve)”. Gjatë qasjes në dokumentacion ne kemi vërejtur se për Inxhinierin e lartëcekur nuk është dhënë asnjë referencë që dëshmon se inxhinieri në fjalë ka menaxhuar ndonjë rikonstruktiv ndërtim apo renovim të ndonjë stadiumi.

Nëse fokusohemi tek referencat e tij të cilat të gjitha i ka lëshuar kompania 100% Design shpk vërejmë se 80 % janë menaxhime të lëmisë infrastrukture.

Ne mendojmë se konsorciumit të propozuar për nënshkrim të kontratës NN 100% Design shpk & Termomontimi nuk e ka plotësuar kërkesën nga Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 b) Udhëheqës i punishtës dhe mendojmë se ky konsorcium është i papërgjegjshëm.



2) Tek dosja e tenderit FTD Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 është kërkuar është kërkuar: pika 3

-Kërkesa

Të paraqitën kontratat e punëve të ngjajshme në tri vitet e shkuara nga data e Njoftimit për kontratë min. 2,000,000.00 €

-Dëshmia

Lista e kontratave – origjinal, të natyrës së ngjajshme në 3 vitet e shkuara nga data e Njoftimi për kontratë të bashkangjiura me kopjet proceseve, raporteve të pranimeve apo të ngjajshme, ku identifikohet qartë, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj) nga institucionet shtetërore ose proceset e pranimeve nga ata privat.

Lideri i konzorciumit të propozuar për kontratë NN 100% Design Shpk ka ofruar listën e projekteve të realizuara në të cilën listë nëse i mbledhim vetëm projektet e përfunduara në 3 vitet e fundit të natyrës së ngjajshme pa i përfshirë ato infrastrukturore si dhe të përfunduara më shumë se 3 vite më heret arrijnë vlerën përafërsisht 480,000.00 €

Kjo mund të vërehet edhe nga Pranimet teknike dhe referencat që i ka ofruar NN 100% Design Shpk shumica nga to janë me afatë të viteve para 2014 me çrast nuk duhet të mirren parasysh pasi që kërkesa nga dosja e tenderit thotë qartë "në tri vitet e shkuara" e poashtu ka paraqitur ka paraqitur edhe kontrata dhe procesverbale të pranimeve teknike për ndërtimin e rrugëve kurse në kërkesën nga FTD shkruan "*kontratat e punëve të ngjajshme*" të cilat nuk përfshihen në punë të ngjajshme ndërtimore. Për këtë mund ta konsultoni edhe KRPP-në ku në shumë raste ka udhëzuar që mos të mirren parasysh kontratat infrastrukturore në tenderët që kanë të bëjnë me ndërtim.

Sa i përket partnerit të konzorciumit Termomontimi Shpk Lista e bashkangjitur për punë të ngjajshme në total ka paraqitur rregullime renovime ose ndërtime të ndriqimit publik të cilat nuk kategorizohen si "*kontratat e punëve të ngjajshme*" siq kërkohet në FTD


Ne mendojmë se konzorciumit të propozuar për nënshkrim të kontratës NN 100% Design shpk & Termomontimi nuk e ka plotësuar kërkesën nga Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 3. Kontratat e punëve të ngjajshme. dhe mendojmë se ky konzorcium është i papërgjegjshëm.

3) Tek dosja e tenderit FTD Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 është kërkuar është kërkuar: pika 2 është kërkuar

-Kërkesa

Të paraqitën paisjet/raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje të domosdoshme).

- a) Eskavator (2 copë)
- b) kamion per transport (4 copë)
- c) Auto vinq (1 copë)
- d) Skip (1 copë)
- e) Kamion me Kran (1 copë)
- f) Cilinder (1 copë)



- g) Auto pompë për beton (1 copë)
- h) Betonjerkë apo marrëveshje për furnizim me beton.

-Dëshmia

Lista e paisjeve - origjinal për të gjitha kërkesat rreth paisjeve të shënuara duhet të ofrohen dëshmitë në kopje dëshmi (kopjet e librezave valide që kompania i ka në pronësi (paisjet të cilat lëvizin në rrugë) kopjet e faturave ose DUD-i etj për paisjet tjera ose të ketë kontratë mbi shfrytëzimin e tyre (qera), Bazë të betonjerkës apo kontratë për furnizim me beton të bashkangjitura me qertifikatën e biznesit, nr. fiskal, dhe Leje (Licencë) për betonjerkë.

Konzorciumi i propozuar për dhënie të kontratës nuk kanë paraqitur cilindër si dhe disa nga kamionët për transport është me afat të skaduar.

Poashtu nuk kemi hasu në marrbveshjepër furnizim me beton.

Ne mendojmë se konsorciumit të propozuar për nënshkrim të kontratës NN 100% Design shpk & Termomontimi nuk e ka plotësuar kërkesën nga Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 2 Mjetet e nevojshme. dhe mendojmë se ky konsorcium është i papërgjegjshëm.

4) Tek dosja e tenderit FTD Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2 është kërkuar

-Kërkesa

Operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi bruto vjetor i OE gjatë tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë ka qenë jo me pak se 3,000,000.00 €.

-Dëshmia


"Deklaratat Tatimore Vjetore" të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (mund të nxirren edhe nga vebfaqja e ATK-së por që duhet të vulosen dhe nënshkruhen nga OE) që konfirmon se Operatori Ekonomik ka pasur të ardhura bruto për 3 vitet e shkuara prej së paku 3,000,000.00 EURO.

Konzorciumi i OE i propozuar për kontratë kanë paraqitu deklaratat tatimore vjetore mirëpo nuk e kanë përfillur kërkesën nga FTD ku shkruan qartë që duhet të vulosen dhe nënshkruhen nga OE.

Ne mendojmë se konsorciumit të propozuar për nënshkrim të kontratës NN 100% Design shpk & Termomontimi nuk e ka plotësuar kërkesën nga Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2 dhe mendojmë se ky konsorcium është i papërgjegjshëm.

5) Tek dosja e tenderit FTD Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 eshte kerkuar është kërkuar:

"Lista e stafit profesional dhe teknik të kompanisë tuaj me të dhënat në vijim: Emri,



mbienuri, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani dhe ka një mesatare në 3 vitet e shkuara minimum 30 të punësuar të regjistruar në raportet e ATK. Në rast të Grupit lideri duhet t'i ketë min 15 punëtorë."

Ndërsa si dëshmi është kërkuar

"Lista e stafit (origjinal dhe e vulosur) për personelin që do të jetë i angazhuar në këtë projekt të bashkangjitur me Raportin nga ATK (mund të nxjerrët edhe nga vebfaqja e ATK-së) që dëshmon numrin që kompania ka një mesatare në 3 vitet e shkuara minimum 30 të punësuar dhe që paraqitja e kontributeve të mos jetë më pak se 6 muaj për secilin punonjës dhe në secilin vit."

Kozorciumi i propozuar për nënshkrim të kontratës nuk ka ofruar asnjë listë për personelin që do të jetë i angazhuar në këtë projekt me të dhënat e kërkuara. Siq është udhëzuar në këtë kërkesë.

Ne mendojmë se konsorciumit të propozuar për nënshkrim të kontratës NN 100% Design shpk & Termomontimi nuk e ka plotësuar kërkesën nga Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 dhe mendojmë se ky konsorcium është i papërgjegjshëm.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne mendojmë se eliminimi i kompanisë tonë BM Group Shpk ka shkaktuar dëme në aspektin ekonomik.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

